



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 060/01-37942

Pejë, datë: 20 Prill 2022



PROCESVERBAL

Nga takimi i IV-të i Komitetit për Politikë e Financa i KK Pejë, mbajtur me 20 Prill 2022, në ora 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, z. Jeton Abazaj Drejtor i Financave, znj Arta Vokshi- Nallbani Drejtoresh e Urbanizimit Mbrojtëjes së Mjedisit, z. Avni Gashi, Udhëheqës i Sektorin të Kuvendit, z. Egzon Kastrat Asistent Administrativ i Kryesuesit, dhe përfaqësuesit e ZIP.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili konstatoj se jemi të gjithë anëtarët prezent. Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin për rendin e ditës, ku i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendos në rend dites dhe kerkoi qe pikat qe kane te bëjnë me kembime të diskutohen parapraksisht për shkak se kryetari ka angazhime tjera shtese.

Unanimisht nga të gjithë prezent me sygjerimet që u dhane u miratu ky:

Rendi i Ditës

- (1) Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
- (2) Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë e Financa: dt. 18. Mars 2022.
- (3) Raportet dhe Rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e SHCK:
 - 3.1. Shqyrtimi i Raportit informativ mbi të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – mars 2022.
 - 3.2. Shqyrtimi i Raportit informativ për Pasqyra financiare të Komunës së Pejës, për vitin 2021.
 - 3.3. Shqyrtimi i propozimit të DUMM për miratimin e Vendimit për dhënjën në Diskutim Publik të Projekt – Hartave Zonale të Komunës së Pejës 2022 – 2030, pas marrjes së Pelqimit nga MMPH.
 - 3.4. Shqyrtimi i kërkesës së “Anibar” Pejë për ndarjen e mjeteve financiare për zhvillimin e aktiviteteve kulturore.
 - 3.5. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe pronarit privat z Valdet Mujaj, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.
 - 3.6. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe pronarit privat z Albert Ajdaj, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.
 - 3.7. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe D&E CONSTRUCT SH.P.K, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.
 - 3.8. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe pronarit z.Hivzi (Ali) Kelmendi, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.
 - 3.9. Shqyrtimi i propozimit për themelimin e Komiteteve tjera:
 - Komitetit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe
 - Komitetit për Shëndetësi.
- (4) Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar.

I.

Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Nuk pat.

II.

Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë dhe Financa: dt. 18 mars 2022.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent, u miratua procesverbali i takimit të Komitetit për Politikë dhe Financa i dates: 18 mars 2022.

III

3.5. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe pronarit privat z Valdet Mujaj, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: kjo pike është e njejt me nje pik që kemi me diskutu ma posht për ni pronë me numer 29 dhe 28 të Albert Ajdaj diqka për mos me diskutu edhe niher është prona përball Bardakiqve që është e rrethume me tel janë 2 ari e 12 metra janë 216 edhe 217 dy prona të cilat gjysmen e tyne e ndrojm me dy prona të Valdet Mujaj 240/28 dhe 610/3 këto prona janë të Mulliri i Haxhi Zekes para kesaj here e kemi pase Jakup Krasniqin tash përfundi aty është prona e këti shtëpia e dytë apo e tretë përfundi mullirit. Këtë pron e ndrojm komplet gjysmen me Valdet Mujajn e gjysen me Albert Ajdaj që e kemi votu heren e kalume.

Me 5 vota pro dhe 2 të përmbajtur i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimi i DÇPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe pronarit privat z Valdet Mujaj, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.

3.6. Shqyrtimi i propozimit të DCPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe pronarit privat z Albert Ajdaj, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: këtu është ai korrigjimi që e permenda ma heret na kemi marr vendim për parcelen 29 e ne fakt është dasht për 28 qeky është korrigjimi qe duhet me bo edhe pse dy her e kom lexu në kuvend por prap se kom vrejti së është gabim.

Znj Xhevahire Ceku-Kelmendi: na edhe heren e kalume në Kpf kemi kërkuar qe te shkohet në rishqyrtim por nuk u marr për bazë kërkesa jon prap se prap mendojm që nuk është relevante vlere e parces qe japet me atë që merret.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: është komisioni i Ministris që ë bon vlersimin së nuk mundemi na me gjet vlere të barabarta me ndrru, komisioni e bënë vlersimin ndonje here i bjen komuna me i pagu privatit e ndonjeher private me i pagu komunës. Ligji nuk lejonn me e shitë pronën komunale . Tash na kemi me qindra problem me prona ka 1 meter ndoshta duhet me i pru 50 prona me ka 1 meter me jau legalizu qytetarëve diqysh përmes kembimeve. Se qeto 3 vitet e ardhëshme veq qesi pronave kom me pru ligji e mundëson këta.

Z. Labinot Panxha: unë po du me potencu ne si aleancë nuk jemi kundër këmbimit të pronave e sidomos atyre që janë ne interes publik por jemi kundër kesaj që me dokumentacion po vjen shumë i mangët këtu prap e ki një kontest gjygesor , qysh e ka përmend edhe Berati heren e kaluar një drejtoresh e jotja e ka monituru këtë proces.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: ska kontest gjygesor ajo është për anën e kunder të rrugës.

Z. Labinot Panxha: ish kanë e ndershme na si asamblesit me pa se a është ligjore apo jo ajo që po e votojm. Sa here që vjen me dokumentacion të kompletuar kom me i votu i ki numrat edhe për këtë po vepron edhe kështu.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ne e kemi marre konfirmimin nga Ministria për harmonizim e shfuqizojm vendimin e seancës se kaluar dhe marrim vendim të ri.

Me 4 vota pro dhe 2 të përmbajtur i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimi i DÇPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe pronarit privat z Albert Ajdaj, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.

3.7. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe D&E CONSTRUCT SH.P.K, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: kjo është prona përball kesaj pronës qe po e vlersojm ka Bardakiqt veq në anën e kundërt, jemi tu dasht me rregullu qatë pjesë të qytetit se e kemi në project me rregullu parkingun edhe parkun duhet me u rregullu parking ka Kapeshnica me 10 ari park, ndërsa në anën tjetër jan edhe 2 ari park tjerë që kanë me ju bashkangjitë kësaj pjese. Këtë pronë e nderrojm me një pronë që është të stadium ajo prona është një trkendesh dhe zgjatet shiqyr që kan qenë interes i ndertusve na atë pjese prej kurqkafit i marrim dikun nja 500 mij euro nderrime i kemi edhe nja 3 prona tjera deri në fund të rrugës që i ndrrojm me tutje kryetari e spjegoj me në detaje pikën në fjalë.

Me 7 vota pro i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimi i DÇPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe D&E CONSTRUCT SH.P.K, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.

3.8. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe pronarit z.Hivzi (Ali) Kelmendi, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: për mu kompletu krejt projektin që po dojm kjo është prona që duhet me u nderru këtë pronë po propozoj me dërgu deri ne kuvend sepse nuk e ka të kryer trashigimin personi është djali i ti nese deri në kuvend nuk e kryen trashigimin e terhekim prej rendi të ditës ather duhet me shku me shpronësim duhet me ja pagu me pare kesh të komunës e ka pru vendimin e gjykatës të 2004 por i mungon një trashigimtar ka thënë qe e bjen edhe pelqimin e ati trashigimtarit tjetër nese se bjen e terhekim nga rendit të ditës.

Z. Berat Ganiqi: nese i mungon një trashigimtar o veper penale.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: jo trashigimtari figuron por mungon pëlqimi prej 6/7 e ka pëlqimin vetëm për 1/7 mungon por nese se bjen deri në kuvend e terhekim prej rendit të ditës.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent me sqarimet që u dhënë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim kuvendit, shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe kryetarit të Komunës për këmbim pronash në mes të komunës së Pejës dhe pronarit z.Hivzi (Ali) Kelmendi, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit, sipas PRRU- “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë, me interes publik.

3.1. Shqyrtimi i Raportit informativ mbi të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – mars 2022.

Z. Jeton Abazaj: ne zakonisht e kemi prezentu këtë raport në muajn Maj por meqense po vlersohemi prej Ministrisë së pushteti lokal me dy pikë po ngutemi me nxan seance e prillit për me u vlersu. Sot përgaditet edhe ju dërgohet në email për me jep vrejte apo sygjerim e kemi shti në rend të dites për mos me humb rendin edhe vlersimin.

Me tetë vota pro i rekomandohet kuvendit për shqyrtim raporti informativ mbi të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar - mars 2022.

3.2. Shqyrtimi i Raportit informativ për Pasqyra financiare të Komunës së Pejës, për vitin 2021.

Z. Jeton Abazaj: është raport financiar vjetor që përgaditet deri me 31 dhjetor dhe kemi pasë afat për korigjim deri me 31 mars të pjesa e pasuris tani vetem është ne process të auditimit nga ana e auditoreve për korrektesi të pasyqrave financiare është përmbledhje e vitit fiskal 2021 duhet të prezentohet në kuvend dhe me pastaj të publikohet ne ëeb të Komunës.

Z. Berat Ganiqi: kjo shpalosja e kërkesave nga padit ne gjygj në vlerë prej 126939 euro?

Z. Jeton Abazaj: dy karakteristika i kena obligim me i shpalos, janë ato që komuna i ka padit operatorët ekonomik dhe obligimet kontigjente ata që e kanë padit komunën, që për ne është shqetesuse pagesa e shuajtave dhe obligimeve tjera që po i kalon milionat në këtë rast edhe të komuna e Pejës. Ka fillu ekzekutimi i këtyre shuajtave dhe unë e kom cek edhe ne një seanc që presim qe diku mbi 1.2 milion euro me qene vlera e këtyre pagesave për shujta. Një fat i mir është qe thesari nuk po i ekzekuton mjetet prej kategorive tjera por po i ekzekuton prej kategoris se pagave meqense kemi vende të lira të punës na mundemi me kalu pa e vrejt shumë në aspektin financiar. Nenshkrimi i kontrates kolektive e ka fut në obligime të medha komunën.

Z. Labinot Panxha: e para ish dasht me menaxhu ma mire këtë sítuate po flas lidhur me padit, cdo akt nënligjor qe nxirret komuna obligohet ti përfill sepse nese është zvoglu tarifa e përmbarusit nuk është zvoglu tarifa e séances sepse ajo varet prej rasti dhe mjetev që trajtohen në atë seanc pra prej borxhit. Keshilla jeme është qe me u konsultu me atë përfaqesuesen ligjore të komunës me ja spjegu. Sepse une kështu kom vepru në spital, unë e kom pa që përfaqsusja e juaj bon edhe revizion për qka për një kërkes që ka bazë ligjore siq është rasti i profesorve pra po bon shpenzime të panevojshme është mire me u ule edhe me bo marveshje me ta.

Z. Jeton Abazaj: na mundemi më padit Ministrin e Arsimit sepse ata duhet me marrë përgjegjesi për atë kontrat e nuk e kanë marr.

Unanimisht nga të gjithë anëtare prezent rekomandohet kuvendit shqyrtimi i Raportit informativ për Pasqyra financiare të Komunës së Pejës, për vitin 2021.

3.3. Shqyrtimi i propozimit të DUMM për miratimin e Vendimit për dhënjën në Diskutim Publik të Projekt – Hartave Zonale të Komunës së Pejës 2022 – 2030, pas marrjes së Pelqimit nga MMPH.

Znj. Arta Vokshi- Nallbani: bazuar ne ligjin 04/ L-174 për planifikimin hapsinor neni 11 Komuna e Pejës e ka dorëzuar draft dokumentin e hartave zonale të komunës për vitin 2022-2030 në Ministrinë e mjedisit infrastruktures dhe planifikimit hapsinor me dt. 18.02.2022 para shqyrtimit publik për ta verifikuar përputhshmerin më planin hapsinor të Kosovës apo edhe me panet zhvillimore për ta marrë pëlqimin nga ana e Ministrisë. DUMM ka dalë me propozim për dhënie në shqyrtim publik të draft dokumentit të HZK-ës më këtë propozim shpallet në diskutim ky projekt, shpallja e këtij draft dokumenti bëhet në sallën e Kuvendit 8 ditë para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ekspozimi bëhet në sallën e kuvendit gjatë kësaj periudhe do të mbahet një proces verbal dhe një liber i ankesave, sygjërimeve, ankesave që vijnë nga qytetarët dhe do të merren parasysh para finalizimit të këtij draft dokumenti. Shpallja e këtij dokumenti bëhet 8 ditë para hyrjes në fuqi të vendimit përmes mjeteve të inofrit në 3 gazeta lokale do të prezantohet në faqen zyrtare të komunës dhe Dumm-së. Në prezantim shpjegohet edhe pjesa tekstuale edhe grafike e materialit, ky projekt do të jetë i qasëm për publikun si në formë fizike dhe elektronike. Shpallja e këtij projekti do të jetë 30 ditë e cila është e rregulluar sipas procedurave ligjore. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi komunal.

Me tetë vota pro i rekomandohet kuvendit shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DUMM për miratimin e Vendimit për dhënjën në Diskutim Publik të Projekt – Hartave Zonale të Komunës së Pejës 2022 – 2030, pas marrjes së Pelqimit nga MMPH.

3.4. Shqyrtimi i kërkesës së “Anibar” Pejë për ndarjen e mjeteve financiare për zhvillimin e aktiviteve kulturore.

Z. Jeton Abazaj: Anibari e ka fituar një projekt që komuna është zotuar që nëse e fitojnë kanë me mbështetje është një projekt që adreson qështjet kulturore në regjion. Meqenëse shuma është mbi 10.000 euro dhe rregullorja 04-2017 mbi financimin e OJQ-ëve nga ana e qeverisë përcakton shuma është mirë që shumat mbi 10.000 euro të kalojnë në kuvend.

Z. Berat Ganiqi: sa i përket anibarit ajo është një emblem kulturore e qytetit të Pejës nuk kam asnjë dyshim a me ja jep a mos me ja jep këto mjete vetem cfar përfaqesimi kulturor i bënë Pejës me rrethin nuk ka nevoj të diskutohet kjo.

Unanimisht nga të gjithë anëtare prezent rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim, shqyrtimi i kërkesë së “Anibar” Pejë për ndarjen e mjeteve financiare për zhvillimin e aktiviteve kulturore.

3.9. Shqyrtimi i propozimit për themelimin e Komiteteve tjera:

- Komitetit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe

- Komitetit për Shëndetësi.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: fjala është për këto dy komitete të tjera, përberja e ketyre komiteteve është 5 anëtar 3 nga kuvendi dhe 2 nga jashtë por që duhet të jenë ekspert të fushës përkatëse. Duhet të kemi parasysh edhe kuoten gjinore. Udhezimi administrativ nuk e lejon me qene anëtarët e kuvendit në dy komitete. Për qështjet që u ngriten lidhur më përfaqësimin është mirë më arritë një marveshje që cdo të tretin komitet me qenë edhe PDK-ja.

Z. Berat Ganiqi: e thjesht meqense jeni bashkëqeverisje një komitet ju një partneri juaj.

Unanimisht nga të gjithë anëtare prezent rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim, shqyrtimi i propozimit për themelimin e Komiteteve tjera, Komitetit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe dhe Komitetit për Shëndetësi.

(4) Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:


Znj Xhevahire Ceku-Kelemndi: anëtari jon i kuvendit e ka hedh një email pak si të ngutshëm lidhur me eshtra në Tabje sepse ka qenë e ditur se aty ka varreza por decitivisht nuk është ditur se ku dhe gjatë punimeve dhe erozionit nga reshjet e shiut aty kanë dal ata eshtra, nuk është bërë e qellimshe sepse anjëri nuk mundemi me qenë ma patriot se tjetri lidhur më këto raste, andaj nuk kisha kërku që të dërgohet në kuvend sepse është disku shumë.

Pjese e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 11:00 h.

Procesmbajtësi,

z. Avni Gashi



KRYESUESI,

z. Rexhep Kurtbogaj

